



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:221498

Datë: 21.12.2022

Numri i dokumentit: 03780764

P.nr.51/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtaret Mentor Hajraj-Kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtareve Veljko Vuqetiç dhe Florije Sylja-anëtar të trupit gjykues, me procesmbajtësen Shqipe Sejdiu, në lenden penale kundër të akuzuarit S.D, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Mitrovice-Departamenti i Krimeve te Renda PP.I.nr.116/19 e dt.26.03.2019, për shkak të veprës penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, e ri-cilësuar nga gjykata ne vepër penale Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-se, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën 03.11.2022, i cili ishte i hapur për publikun ne te cilin kane prezantuar Prokurori i Prokurorisë Themelore ne Mitrovice Njazi Rexha, i akuzuar, mbrojtësi i tij av.Nebojsa Vllaiç dhe i autorizuari i palës se dëmtuar av. Miodrag Brklač, me dt.07.11.2022, publikisht e ka shpall, kurse me datën 21.12.2022, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S.D, i biri i .. dhe .., e vajzërisë .., i lindur me .. në fshatin .., komuna e .., ku edhe jeton në rrugën “..”, nr. .., me numër personal .., serb, shtetasi i Republikës së Kosovës, pensioner, i martuar, babai i .. fëmiu, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes së dobët ekonomike, me parë i pa gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Në periudhën kohore prej dt. 01.01.2005 e gjer me dt. 31.12.2015, në cilësinë e shefit te kontabilitetit në kompanitë “Auto Moto Drushtovo” në Mitrovicë dhe “Auto Moto Remont”

në Mitrovicë, ka keqpërdorur autorizimet e tij duke i sjell vetes dobi pasurore te kundërligjshme dhe duke i shkaktuar dem personit interesat pasurore te te cilit ai i përfaqësonte-kompanitë e lartcekura, në atë mënyre që si kontabilist duke mos regjistruar në evidencat e kontabilitetit kthimin e akontacioneve (paradhëniet të punëtove), duke tërhequr para kesh nga banka dhe te njëjtat nuk janë regjistruar fare në evidencën e kontabilitetit, duke mos dorëzuar pazarin ditor në llogarinë bankare të kompanisë, e duke mos i regjistruar në evidencat e kontabilitetit paratë e kthyer nga personat që kishin huazuar para nga kompania, dhe ne këtë mënyrë kompanisë “Auto Moto Drushtvo”, me veprimet e te akuzuarit i është shkaktuar dem ne lartësinë prej 15,689,595 dinar, kurse kompanisë “ Auto Moto Remont” i është shkaktuar dem prej 21,222,954 dinar, qe gjithsej dem për te dy kompanitë arrin vlerën prej 36,912,549 dinar, e konvertuar ne euro 273,107.39 euro.

- Me këtë ka kryer veprë penale **Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-së.**

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 41, 45 dhe 73 të KPRK-së, lidhur me nenet 365, 450 par. 2.6 dhe nenit 463 par. 2 të KPP-së, i:

SH Q I P T O N

DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vjet, i cili dënim do te ekzekutohet pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

OBLIGOHET i akuzuari që në emër të kërkesës pasurore-juridike për demin e shkaktuar të dëmtuarës kompanisë “Auto Moto Drushtvo”, t’i paguaj shumën prej 15,689,595 dinar, kurse kompanisë “ Auto Moto Remont” t’i paguaj shumen prej 21,222,954 dinar, apo gjithsej për te dy kompanitë shumen prej 36,912,549 dinar, e konvertuar ne euro 273,107.39 euro, te cilat është i obliguar qe t’i paguaj ne afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes se formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej njëqind (100) Euro, si dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit ta paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro.

A r s y e t i m

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PPI.nr.116/19 të datës 26.03.2019, kundër të akuzuarit S.D, për shkak të veprës penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës:

Kjo çështje penale sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit PA1.nr.256/2020, të dt.18.03.2021, është kthyer në rivendosje.

Fillimisht për këtë çështje penale janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me dt.10.03.2022, 04.05.2022, 18.10.2022, i cili shqyrtim gjyqësor është filluar rishtazi bazuar në dispozitën ligjore nga neni 311 par.3 të KPP-se, meqenëse nga shqyrtimi i fundit gjyqësor kishin kaluar me shumë se 3 muaj, dhe shqyrtimi i fundit gjyqësor është mbajtur me dt.03.11.2022.

Në secilin prej shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura, gjykata të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij në cilësinë e palës së akuzuara. I njëjtit ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe për mbrojtës sipas autorizimit ka autorizuar av. Nebojsa Vllaiq.

Po ashtu gjykata edhe palën e dëmtuar S.M, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.10.03.2022, e ka njoftuar me të drejtat e tij si palë e dëmtuar. I njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij, dhe për mbrojtës e ka angazhuar av.Miodrag Brklaq, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore-juridike të njëjtën i autorizuar i tij av. Miodrag Brklaq e paraqiti në fjalën përfundimtare dhe atë për të dy kompanitë në vlerë prej 273,107.39 euro.

Shpallja publike e aktgjykimit është bërë me dt.07.11.2022, në prezencë të mbrojtësit të akuzuarit av. Nebojsa Vllaiq dhe të dëmtuarit S.M, e në mungesë të palëve tjera.

Me aktvendimin e Nënkryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë GJA.nr.07/2022, të dt.06.12.2022, është lejuar zgjatja e afatit për përpilimin e aktgjykimit edhe për 60 ditë tjera.

Provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor;

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë dëgjuar dëshmitarët S.M, M.M, S.J, D.S dhe D.V, si dhe eksperti financiar Naser Rusinovci, dhe janë administruar këto prova materiale: Raporti ekspertit financiar-ekspert gjyqësore i drejtimit Ekonomiko-Financiar Naser Rusinovci, Kontrata mbi rregullimin e të drejtave e detyrave dhe përgjegjësiive mes S.D dhe firmës “Auto Moto Drushtov” Mitrovicë, nr. 134 datës 25.03.1986, të freskuar me kontratën nr 81/29 te datën 01.08.2003, Kontrata nr. 05/11 te datën 01.11.2011, për ofrimin e shërbimeve për mbajtjen e kontabilitetit, sipas Ligjit të kontabilitetit të RS dhe Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, Vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies se punës për shkak të pensionimit nr. 07/11 te datës 04.01.2011, Ditarin e arkës i datës 31.01.2011, Ditarin i arkës i datës 31.05.2011, Ditarin e arkës i datës 31.07.2011, Ditarin e arkës i datës 31.08.2011, Certifikatën e regjistrimit të U.P “Auto Moto Drushtov” Mitrovicë, me numër te biznesit 70145397, Certifikatën e regjistrimit “Auto Moto Drushtov” Mitrovicë, numër te biznesit 70145397, pasqyra nr.1 viti 2005, Evidenca e AMD Mitrovicë, Pasqyra nr. 1 viti 2006, Evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2007 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2008 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2009 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2010 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2011 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2008 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2009 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2010 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2011 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2012 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2013 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2014 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2015 evidenca e AMR Mitrovicë, Shtojca nr. 1 nga pasqyra e realizimit te të ardhurave nga kontrolli teknik për vitin 2015 sipas muajve, përmbledhjen komulative të “Auto Moto Remont” Mitrovicë për vitin 2008 gjer ne vitin 2015 për parregullsitë e gjetura nga ana e komisionit përmbledhjen komulative “Auto Moto Drushtvo” për vitin 2005-2014 dhe parregullsitë të gjetura nga ana e komisionit.

Propozimet nga palët ne shqyrtim gjyqësor;

Ne shqyrtim gjyqësor, mbrojtësi i të pandehurit S.D, av.Nebojsa Vllaiq, i ka propozuar gjykates qe nga Administrata Tatimore e Kosoves te kerkoje vertetim per numrin e punetoreve per kompanin “Auto Moto Drushtvo” dhe se a jane te paguara kontributet e punetoreve. Ky mbrojtës po ashtu i ka propozuar gjykates qe te merret llogarija bankare per Auto Moto Drushtvo prane NLB bank apo banka Raiffaissen dhe ne cilesin e deshmitarit te degjohet D.V.

Gjykata e ka refuzuar propozimin sa i perket vertetim te Administrates Tatimore te Kosoves, per numrin e punetorve per kompanin “Auto Moto Drushtvo” dhe se a jane te paguara kontributet e punetoreve prane Administrates Tatimore te Kosoves me arsyetimin se gjykata vlersoi se nje gje e tille eshte e parendesishme per qeshtjen, ndersa propozimin qe gjykata ta merr llogarine bankare per Auto Moto Drushtvo prane NLB bank apo banka Raiffaissen, gjykata edhe kete propozim e refuzoje me arsyetimin ne rastin konkret nuk eshte e rendesishme per qeshtjen llogarija bankare e kesaj kompanije,per me teper mbrojttesi nuk ishte i sigurt ne propozimin e tij se ne cilen banke eshte kjo llogari bankare. Sa i perket propozimit per degjimin e deshmitarit D.V, gjykata ka aprovuar kete propozim dhe te njejtin e ka degjuar ne shqyrtim gjyqesor.

Paraqitja e mbrojtjes nga i akuzuari;

I akuzuari ne shqyrtimet gjyqësor, qofte ne shqyrtimin paraprake, qofte ne shqyrtimin ne rigjykim është mbrojt ne heshtje.

-Fjala përfundimtare e palëve;

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, Njazi Rexha, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: se duke marr parasysh se nga dëgjimi i dëshmitarëve, dëgjimi i ekspertit nuk ka ndryshim ne gjendjen faktike, mbes ne tersi pranë fjalës përfundimtare te dhënë ne procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor te dt.09.03.2022, ne te cilën kishte deklaruar se pas mbajtjes se shqyrtimeve gjyqësore dhe administrimit te provave pa mëdyshje rezulton se me veprimet e të akuzuarit S.D përmbahen elementet e veprës penale Përvetësimi në detyre nga neni 425 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së. Në cilësinë e shefit të kontabilitetit rezulton se ka përvetësuar të hollat që i janë besuar në bazë të detyrës: duke mos regjistruar në evidencat e kontabilitetit kthimin e akontacioneve, duke tërhequr para kesh nga banka dhe të njëjtat nuk janë regjistruar fare në evidencën e kontabilitetit, duke mos dorëzuar pazarin ditor në llogarinë bankare të kompanisë, duke mos regjistruar në evidencat e kontabilitetit parat e kthyera nga personat e tretë që kishin huazuar nga kompania. Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga deklaratat e dëshmitareve: M.M, D.S, S.M dhe S.J. Ndërmarrja duke parë se është duke u futur ne një krizë financiare, me insistimin e punëtoreve ka mbajtur një mbledhje gjate se cilës kane ardhur në përfundim se gjendja e rendë financiare në “Auto Moto Drushtovo” dhe “Auto Moto Remont” është si pasoj e keqpërdorimit të financave nga shefi i kontabilitetit S.D, për ç’arsye kjo krize financiare ka sjellë deri te gjendja që të formohet një komision nga ana e punëtoreve dhe përcillet gjendja financiare për një muaj, gjë të cilën e kanë bërë punëtorët D.S dhe S.J, dhe pasi që kane përcjellë gjendjen financiare për një muaj, ka rezultuar se te hyrat financiare kanë

qenë në vlerë prej 100.000 dinar, ndërsa kur organizohet mbledhja e punëtorëve me qëllim të vlerësimit të gjendjes financiare për të njëjtin muaj, shefi i kontabilitetit prezanton se të hyrat kanë qenë në vlerë 50.000 dinar, çka kanë shtyre drejtorin dhe punëtorët e ndërmarrjes që të bëjnë vlerësimin e gjendjes financiare për vitin 2016 me ç ‘rast gjatë vlerësimit të punës për vitin 2016, komisioni ka konstatuar mungesën prej 25.000 euro, e cila mungese i është prezantuar edhe drejtorit S.M e të cilën mungese e ka pranuar edhe shefi i kontabilitetit dhe me insistimin e drejtorit është kthyer shuma prej 20.000 Euro. Përveç komisionit të formuar nga ndërmarrja për një vlerësim sa me detal ndërmarrja ka angazhuar edhe një kontabilist të licencuar e i cili pas analizimit të rezultateve të punës ka ardhur me vlera të përafërta me komisionin e ndërmarrjes. Kjo gjendje faktike e përshkruar nga punëtorët e ndërmarrjes është vërtetuar edhe nga pasqyra e evidencës për vitet për “Auto Moto Drushtovo” dhe “Auto Moto Remont” dhe ekspertiza financiare e punuar nga eksperti Naser Rusinovci. Sipas ekspertit Naser Rusinovci rezulton se i akuzuari S.D si shef i kontabilitetit për periudhën e cekur nuk ka udhëhequr kontabilitet të mirëfilltë për subjektin “Auto Moto Drushtovo” në Mitrovicë dhe se nuk ka regjistruar në evidencat e kontabilitetit kthimin e akontacioneve, ka tërhequr para kesh nga banka dhe të njëjtat nuk i ka regjistruar fare në evidencën e kontabilitetit, nuk dorëzon pazare ditore në llogarinë bankare të kompanisë, nuk regjistron në evidencat e kontabilitetit paratë e kthyer nga personat që kishin huazuar para nga kompania kryesisht për regjistrimin e veturave dhe me këto veprime kompanisë i ka shkaktuar dëm prej 33,571.588.84 dinar ose të konvertuar në Euro 273.107.79 Euro, e të gjitha këto i ka elaboruar në ekspertizën financiare mbi bazën e dokumenteve burimore për vitet nga 2005-2016. Andaj duke marr parasysh të cekurat me lartë konsideroj se i akuzuari S.D duhet të shpallet fajtor për veprën e kryer penale e me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit duhet ti keni parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, veçanërisht si rrethane rënduese të merret kufijtë e dashjes se të akuzuarit në kryerjen e veprës penale.

I autorizuari i të dëmtuarës Av. Miodrag Brkljaq, në fjalën përfundimtare deklaron: Se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit, i cili në detaje dhe në mënyrë të analizuar e ka treguar mënyrën në të cilën i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet. Nuk ka asnjë lloj nevojë që t’i përsëris fjalët e tij por vetëm dua që ti përkrah qëndrimet dhe vlerësimet e tij në të gjitha provat. Ajo që ka qenë kontestuese gjatë këtij shqyrtimi ka qenë çështja e modalitetit dhe mënyrës në të cilën është kryer vepra penale, gjegjësisht a kanë qenë veprimet që eventualisht i pandehuri i ka ndërmarr a mund të kualifikohen si vepra penale Përvetësim në detyrë. Unë mendoj që prokurori pa asnjë lloj dyshimi u ka prezantuar dhe ka treguar që provat që janë administruar gjatë këtij gjykimi pa asnjë dyshim tregojnë se i pandehuri me të vërtetë e ka

kryer veprën penale në fjalë. Tash kujtoj maksimalisht se firma të cilën unë e përfaqësoj i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe në baze të nenit 354 të KPP-së parashtron kërkesë pasurore-juridike në vlerë që është vërtetuar gjatë kësaj procedure 273.107.79 Euro, e cila është paraqitur në mënyre të hollësishme në aktakuzë. Kjo shumë nëse do të konvertohej në dinarë në momentin kur është kryer ekspertiza e kam shumën prej 33,571.588.84 dinar. Vetëm do të shtoj se provat me të rëndësishme të cilat e tregojnë përvetësimin e këtyre mjeteve nga i akuzuari janë gjetjet dhe mendimi i ekspertit financiar dhe urdhëresa e arkës nga 17 shkurti i vitit 2016, e cila është përpiluar nga vet i akuzuari e që e kap shumën prej 20.000 Euro e që kanë të bëjnë me kthimin e akontacioneve të punëtorëve të cilat nuk janë regjistruar në vitin 2015,2014, 2013. Kjo prove që vet i pandehuri ia ka kthyer firmës 20.000 Euro në kesh në mënyrën me të mirë direkt vërteton se i pandehuri gjatë këtyre viteve në mënyrën ashtu siç e ka shpjeguar prokurori ka përvetësuar shumat e caktuara për të ardhur deri te kjo.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.D, av. Nebojsa Vllaiq, deklaroj se i akuzuari nuk mund te gjykohej për veprën penale për të cilën ai akuzohej, pasi që ai akuzohej për veprën penale Përvetësim ne detyre nga neni 425 par.3 te KPRK-se. Këtë vepër penale mund ta krye vetëm personi zyrtar dhe askush tjetër, nëse kryesi nuk e ka këtë cilësi atëherë eventualisht mund te jete një vepër tjetër penale por jo kjo. Neni 120 par.2 i KPRK-se ka përcaktuar domethënien e personit zyrtar dhe i akuzuari nuk i gëzon ato attribute dhe i ka propozuar gjykatës që aktakuza te refuzohet.

I akuzuari S.D, gjatë gjithë procedurës nuk është deklaruar, por i njëjti e ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore që të mbrohet në heshtje, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e përkrahu fjalën e mbrojtësit të tij, av. Nebojsa Vllaiq, dhe nuk ka çka të shtoj.

Faktet e vërtetuara nga gjykata pas administrimit te provave ne shqyrtim gjyqësor:

Pas administrimit te gjitha provave ne shqyrtim gjyqësor dhe pas analizimit te tyre gjykata ka vërtetuar faktet si ne vijim:

-Faktin se i akuzuari S.D, ka punuar si shef i kontabilitetit në kompanitë “Auto Moto Drushtovo” në Mitrovicë dhe “Auto Moto Remont” në Mitrovicë, kjo u vërtetua nga deklarimi i dëshmitarëve ne shqyrtim gjyqësor dhe nga provat tjera materiale si Kontratën mbi rregullimin e të drejtave e detyrave dhe përgjegjësisve mes S.D dhe firmës “Auto Moto Drushtov” Mitrovicë, nr. 134 datës 25.03.1986, të freskuar me kontratën nr. 81/29 te datën 01.08.2003, Kontrata nr. 05/11 te datën 01.11.2011, për ofrimin e shërbimeve për mbajtjen e kontabilitetit.

-Faktin se shkak i mungesës së mjeteve financiare për pagesën e pagave për punëtorët në vitin 2016, është formuar komision për ta vërtetuar gjendjen financiare për kompanitë “Auto Moto Drushtvo” dhe Auto Moto Remont”, për vitet 2005-2015, kjo u vërtetua nga dëshmitë e dëshmitarëve S.M, M.M, S.J dhe D.S, ngase të gjitha këta dëshmitar në shqyrtim gjyqësor deklaruan një fakt të tillë dhe se tre dëshmitarët e fundit ishin edhe anëtar të këtij komisioni.

-Faktin se komisioni për të vërtetuar gjendjen financiare për kompanitë “Auto Moto Drushtvo” dhe Auto Moto Remont”, për vitet 2005-2015, ka hasur në mungesë të mjeteve nga të hyrat për këto kompani, kjo u vërtetua nga dëshmitë e dëshmitarëve S.M, M.M, S.J dhe D.S, ngase të gjitha këta dëshmitar në shqyrtim gjyqësor deklaruan një fakt të tillë.

- Faktin se me kërkesën e Drejtorit të kompanive i akuzuari me dt.17.02.2016,ka kthyer shumën e të hollave në shumë prej 20.000 euro, kjo u vërtetua nga dëshmitë e dëshmitarëve S.M, M.M, S.J dhe D.S, ngase të gjitha këta dëshmitar në shqyrtim gjyqësor deklaruan një fakt të tillë.

-Faktin se kompanive “Auto Moto Drushtvo” dhe Auto Moto Remont”, për vitet 2005-2015, me veprimet e të akuzuarit u është shkaktuar dëm, që në rastin konkret dëmi për kompaninë “Auto Moto Drushtvo”, ishte në lartësi prej 15,689,595 dinar, kurse për kompaninë “Auto Moto Remont” në lartësi prej 21,222,954 dinar, që gjithsej dëmi për të dy kompanitë arrin vlerën prej 36,912,549 dinar, e konvertuar në euro 273,107.39 euro, kjo është vërtetua nga ekspertiza Financiare e ekspertit financiar Naser Rusinovci dhe nga deklarimi i këtij eksperti në shqyrtimet gjyqësore.

Vlerësimi i provave;

Gjykata në mbështetje të nenin 361 të KPP-se, provat e administruara në shqyrtim gjyqësor i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në lidhje edhe me provat tjera dhe me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë penale për të akuzuarin, para se gjithash u bazua në provat si në vijim:

-Në dëshminë e dëshmitarit S.M, nga e cila u vërtetuar se ky dëshmitar ka qenë drejtor në dy firma-kompanitë “Auto Moto Remont” dhe “Auto Moto Drushtvo” dhe atë nga viti 2005 e deri në vitin 2012/2013, deri kur është pensionuar, dhe se shef i kontabilitetit ka qenë i akuzuari S.D. Në vitin 2016 kanë vërejtur se nuk ka të holla të mjaftueshme për pagesën e punëtorëve, ku pas kësaj ka mbajtur mbledhje me punëtorët dhe kanë vërtetuar keqpërdorime. Pas kësaj e ka formuar

komisionin për konstatimin e gjendjes financiare në kompani, i cili komision ka filluar punën për konstatimin e gjendjes financiare për muajin dhjetor të vitit 2015 dhe për tërë vitin 2015, ku kanë vërtetuar që mungojnë 25.000 Euro. Me kërkesën e këtij dëshmitari ne cilësinë e drejtorit i akuzuari me datën 17.02.2016, i ka kthyer shumën e të hollave në vlerë prej 20.000 euro dhe ka pranuar se këto të holla i ka marr, pas kësaj kanë vazhduar që të hetojnë më tutje dhe komisionin në përbërje të D.S, M.M dhe S.J dhe ky komisioni ka bërë kontrollimin e punës edhe për 10 vite mbraja të këtyre kompanive dhe ka konstatuar mungesë nga të hyrat për këto 10 vite në shumë prej 305.000 Euro.

-Ne dëshminë e dëshmitares *M.M*, nga e cila u vërtetua se e njëjta ka punuar në kompanitë e lartcekura në sportel si punëtores e administratës në regjistrimin e automjeteve. Meqenëse është konstatuar mungesë e mjeteve për pagat e punëtorëve, atëherë është formuar një komision ku edhe dëshmitarja ka qenë anëtare e atij komisioni së bashku me D.S dhe S.J, për ta shikuar gjendjen financiare të organizatës. Si komision për fillim kanë konstatuar gjendjen financiare vetëm për një muaj, e cila gjendje nuk është përputhur me gjendjen financiare që e ka paraqitur kontabilisti S.D, pasi që kontabilisti ka paraqitur gjendjen financiare më të vogël se sa që kanë gjetur këta si komision, dhe dallimi ka qenë për 50.000 dinar. Pasi që është konstatuar kjo mungesë e parave kanë filluar me regjistrimin për vitet paraprak, dhe për vitin 2015 kanë konstatuar mungesë prej 25.000 euro, të cilën mungesë ja kanë prezantuar drejtorit S.M, i cili pastaj e ka ftuar kontabilistin në një takim me punëtores që të prezantoj këtë gjendje financiare, ku kontabilisti e ka pranuar se ka keqpërdorime në “Auto Moto Drushtov” dhe “Auto Moto Remont”, dhe pastaj në mënyrë demonstrative e ka lëshuar takimin duke thënë “kush jeni ju që të më kontrolloni mua”. Pas kësaj mungesë prej 25.000 euro, kanë filluar me regjistrim edhe për vitet e tjera. Gjatë punës si komision për këto 10 vite, në disa mënyra është vërtetuar se ka mungesë në arkë, mospërputhshmëri në raport me mjetet e kërkuara në arkë, kthimi i akontacioneve nuk është regjistruar, pastaj është paraqitur se gjoja drejtori ka tërhequr mjete dhe iu ka paguar personave të tretë, kurse kjo nuk ka qenë e sakte dhe janë bërë malverzime të ndryshme.

-Ne dëshminë e dëshmitarit *S.J*, nga e cila u vërtetua se nuk ka pasur mjete financiare për pagesën e pagave të punëtorëve dhe pas kësaj drejtori ka formuar komisionin nga punëtores, dhe këta punëtor e kanë bërë kontrollin e gjendjes financiare dhe për tri vitet e fundit të cilët kanë vrenjtur mungesë rreth 25.000 euro në kundërvlerë me dinar. Pas 2-3 muajve të punës, këta e kanë përfunduar kontrollin, dhe drejtori e ka angazhuar një kontabilist të licencuar, i cili ka bërë

vështrimin e foto dokumentacionit dhe ka gjetur edhe me shumë malverzime. Pastaj komisioni e ka bërë kontrollin edhe për 10 vite paraprake dhe kanë gjetur shumë shpërdorime të mëdha. Kur e kanë përfunduar punën në komision, dëshmitari deklaroi se ky e ka nxjerr një kurs mesatar dhe e ka shndërruar mungesën sipas dijenisë së tij e që ka qenë dikund rreth 350.000 Euro, shuma e saktë nuk ju kujtohet, por deklaroi se ekziston dokumentacioni. Shuma e tyre si komisionit të cilën shumë e kanë gjetur për dallim nga shuma e kontabilistit të licencuar, ka pasur dallime por shumë të vogla.

-Ne dëshminë e dëshmitarit *D.S*, nga e cila u vërtetua se i njëjti ka punuar në “Auto Moto Drushtov” prej vitit 1984. Nga viti 1986, shefi i kontabilitetit ka qenë *S.D*. Ne vitin 2016, për arsye se nuk ka pasur të holla për të ardhurat personale dhe atëherë punëtorët janë ankuar konkretisht nga kontrolli teknik pasi që në bazë të shërbimeve që janë kryer kanë konkluduar se duhet të ketë të ardhura dhe për këtë arsye kanë shkruar te drejtori dhe ai e ka formuar komisionin për ta vërtetuar gjendjen financiare për muajin janar 2016. Atëherë komisioni ka vërtetuar që ka pasur keqpërdorim, dhe drejtori ka urdhëruar që të bëhet kontrollimi edhe për vitin 2015 pastaj edhe për vite tjera paraprake. Pas këtij kontrolli, komisioni e ka bërë raportin me shkrim. Shefi i kontabilitetit ka pranuar se ka pasur mungesë të mjeteve ashtu sikurse e ka konstatuar komisioni dhe ka deklaruar se do t’i kompensoj, dhe diferenca e komisionit dhe shefit të kontabilitetit, me sa ju kujtohet ka qenë rreth 30.000-40.000 dinar. Për vitin 2015 diferenca ka qenë shumë e madhe dhe për këtë shefi i kontabilitetit është deklaruar se do t’i kompensoj dhe atë e ka bërë duke ja dorëzuar drejtorit me dëftesë 20.000 euro, ku në dëftesë shkruan data kur i ka dorëzuar. Si anëtar i komisionit gjatë punës si komision kanë hasur që punëtorëve ju është dhënë akontacion nga shefi i kontabilitetit e kthimi i këtij akontacioni nuk është evidentuar në arkë. Gjatë punës gjithashtu kanë hasur se janë tërhequr para kesh nga banka të cilat nuk janë evidentuar në evidencën e kontabilitetit.

Me rastin e vendosjes si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata dëshmisë se dëshmitarëve *S.M*, *M.M*, *S.J* dhe *D.S* ua fali besimin e plote pasi që të njëjtat kishin mbështetje dhe plotësonin njëra tjetrën dhe ne baze të këtyre dëshmive u vërtetua fakti se fillimisht në vitin 2016, kishte mungesë të mjeteve financiare për pagesën e pagave të punëtorëve, dhe pas kësaj është formuar komision ne përbërje prej *M.M*, *S.J* dhe *D.S*, i cili komision ka konstatuar se për vitet 2005-2015, ka mungesë të mjeteve nga të hyrat për dy ndërmarrët “Auto Moto Drushtvo” dhe “Auto Moto Remont”.

Po ashtu me rastin e vendosjes si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi gjykata u bazua ne ekspertizën e ekspertit financiar Naser Rusinovci e dt.27.08.2018, pasi qe nga ekspertiza e ekspertit financiar u vërtetua se i pandehuri me veprimet e tij kompanisë “Auto Moto Drushtvo”, i ka shkaktuar demi dhe atë:

- për vitin 2005, ne emër te pagave neto 2,699,102.43 dinar dhe tërheqje e parave nga banka 1,150,00.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2005, është 3,849,102.43 dinar.

-për vitin 2006, ne emër te pagave neto 2,788,749.54 dinar, tërheqje e parave nga banka 123,600.00 dinar, dhe shmangie e xhiros se ditës 168,790.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2006, është 3,081,139.54 dinar.

-për vitin 2007, ne emër te pagave neto 2,214,109.63 dinar, huazime personave te trete 366,977.00 dinar, tërheqja e parave nga banka 360,000.00 dinar dhe shmangie e xhiros se ditës 312,788.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2007, është 3,253,874.63 dinar.

-për vitin 2008, ne emër te pagave neto 2,105,683.64 dinar, huazime personave te trete 242,500.00 dinar dhe tërheqja e parave nga banka 591,800.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2008, është 2,939,983.64 dinar.

-për vitin 2009, ne emër te pagave neto 612,038.84 dinar, huazime personave te trete 937,000.00 dinar dhe tërheqja e parave nga banka 56,300.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2009 1,614, është 338.84 dinar.

-për vitin 2010, ne emër te pagave neto 630,412.52 dinar, huazime personave te trete 32,214.00 dinar dhe tërheqja e parave nga banka 413,955.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2010, është 1,094,608.52 dinar.

-për vitin 2011, ne emër te pagave neto 444,279.56 dinar, huazime personave te trete 59,092.00 dinar dhe tërheqja e parave nga banka 267,600.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2011, është 770,971.56 dinar.

Sipas ekspertizës financiare demi i tërësishëm për kompaninë “Auto Moto Drushtvo” për vitet 2005-2011, është 15,689,595 dinar.

Po ashtu nga ekspertiza e ekspertit financiar Naser Rusinovci e dt.27.08.2018, u vërtetua se i pandehuri me veprimet e tij kompanisë “Auto Moto Remonte”, i ka shkaktuar demi dhe atë:

-për vitin 2008, ne emër te akontacioneve 1,278,400.00 dinar, diferencia ne te ardhura personale 2,434,317.64 dinar, huazime personave te trete 217,051.00 dinar, shmangia e te hyrave 42,200.00

dinar dhe tërheqja e parave nga banka 245,000.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2008, *është 4,216,968.64 dinar.*

-për vitin 2009, ne emër te pagave neto 1,513,610.87 dinar, qe ishte dem i tërësishëm për vitin 2009.

-për vitin 2010, ne emër te pagave neto 1,351,016.19 dinar, pagesa te ndryshme 2,429,340.00 dinar dhe tërheqje e parave kesh 1,095,000.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2009, *është 4,875,356.19 dinar.*

-për vitin 2011, ne emër te pagave neto 1,411,483.80 dinar, pagesa e shujtës se ngrohte 370,812.00 dinar, pagesa te ndryshme 25,000.00 dinar dhe tërheqja e parave kesh 1,027,000.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2011, *është 2,834,295.80 dinar.*

-për vitin 2012, ne emër te pagave neto 1,184,740.01 dinar, pagesa e shujtës se ngrohte 420,495.00 dinar, pagesa te ndryshme 607,000.00 dinar dhe tërheqja e parave kesh 607,000.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2012, *është 2,242,893.01 dinar.*

-për vitin 2013, ne emër te pagave neto 1,154,486.20 dinar, pagesa e shujtës se ngrohte 265,200.00 dinar, pagesa te ndryshme 45,200.00 dinar dhe tërheqja e parave kesh 110,000.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2013, *është 1,574,886.20 dinar.*

-për vitin 2014, ne emër te pagave neto 1,056,477.64 dinar, pagesa te ndryshme 14,000.00 dinar dhe tërheqja e parave kesh 105,454.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2014, *është 1,175,931.64 dinar.*

-për vitin 2015, ne emër te pagave neto 800,666.33 dinar dhe shmangia e pazarit ditor 161,368.00 dinar, apo demi i tërësishëm për vitin 2015, *është 962,034.33 dinar.*

Sipas ekspertizës financiare demi i tërësishëm për kompaninë “Auto Moto Remonte” për vitet 2008-2015, është 21,222,954 dinar.

Edhe nga deklarimi i ekspertit financiar Naser Rusinovci ne shqyrtim gjyqësor, u vërtetua se i akuzuari me veprimet e tij kompanisë “Auto Moto Drushtvo” për vitet 2005-2011, i ka shkaktuar dem ne lartësinë prej 15,689,595 dinar, kurse kompanisë “ Auto Moto Remont” për vitet 2008-2015, i ka shkaktuar demi prej 21,222,954 dinar, qe gjithsej demi për te dy kompanitë arrin vlerën prej 36,912,549 dinar, e konvertuar ne euro 273,107.39 euro.

Andaj me rastin e vendosjes si ne dispozitiv te aktgjykimit, gjykata ekspertizës se ekspertit financiar dhe deklarimit te tij ne shqyrtimet gjyqësore ua fali besimin e plote pasi qe te njëjtat kishin përputhje me dëshmitë e dëshmitareve dhe me shkresat tjera te lendes, e nga te cilat u

vërtetuan fakte të rëndësishme të përshkruara si në përshkrimin faktin të dispozitivit të aktgjykimit, si koha, vendi, mënyra dhe dem i shkaktuar kompanive që në rastin konkret ishte për kompaninë “Auto Moto Drushtvo”, për vitet 2005-2011, në lartësinë prej 15,689,595 dinar, kurse për kompaninë “ Auto Moto Remont” për vitet 2008-2015, në lartësi prej 21,222,954 dinar, që gjithsej dem për të dy kompanitë arrin vlerën prej 36,912,549 dinar, e konvertuar në euro 273,107.39 euro.

Përveç provave të cekura si më lartë gjykata me rastin e marrjes së vendimit i vlerësoi dhe u bazua edhe provat materiale të cilat i ka administruar në shqyrtim gjyqësor si:

-Kontratën mbi rregullimin e të drejtave e detyrave dhe përgjegjësiwe mes S.D dhe firmës “Auto Moto Drushtov” Mitrovicë, nr. 134 datës 25.03.1986, të freskuar me kontratën nr 81/29 të datën 01.08.2003, Kontrata nr. 05/11 të datën 01.11.2011, për ofrimin e shërbimeve për mbajtjen e kontabilitetit, sipas Ligjit të kontabilitetit të RS dhe Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, nga e cila u vërtetua se kompanitë Auto Moto Drushtvo dhe Auto Moto Remont, në cilësinë e kontabilistit kanë angazhuar të akuzuarin S.D.

- Vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit nr. 07/11 të datës 04.01.2011, me të cilin u vërtetua se të akuzuarit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

- Ditarin e arkës i datës 31.01.2011, Ditarin i arkës i datës 31.05.2011, Ditarin e arkës i datës 31.07.2011, Ditarin e arkës i datës 31.08.2011.

-Certifikatën e regjistrimit të U.P “Auto Moto Drushtov” Mitrovicë, me numër të biznesit 70145397, Certifikatën e regjistrimit “Auto Moto Drushtov” Mitrovicë, numër të biznesit 70145397, nga e cila u vërtetua se kjo kompani pranë ARBK është e regjistruar si biznes individual.

-Pasqyra nr.1 viti 2005, Evidenca e AMD Mitrovicë, Pasqyra nr. 1 viti 2006, Evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2007 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2008 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2009 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2010 evidenca e AMD Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2011 evidenca e AMD Mitrovicë.

-Pasqyra nr.1 viti 2008 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2009 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2010 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2011 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2012 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2013 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2014 evidenca e AMR Mitrovicë, pasqyra nr.1 viti 2015 evidenca e AMR Mitrovicë.

- Shtojca nr. 1 nga pasqyra e realizimit të të ardhurave nga kontrolli teknik për vitin 2015 sipas muajve.

-Përmbledhjen komulative të “Auto Moto Remont” Mitrovicë për vitin 2008 gjer ne vitin 2015 për parregullsitë e gjetura nga ana e komisionit përmbledhjen komulative “Auto Moto Drushtvo” për vitin 2005-2014 dhe parregullsitë të gjetura nga ana e komisionit.

Andaj gjykata me rastin e vendosjes si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, provave personale-dëshmime te dëshmitareve, deklarimit te ekspertit ne shqyrtim gjyqësor, ekspertizës financiare, dhe provave materiale ua fali besimin e plote, ngase te njëjtat nuk kishin kundërthënie mes njëra tjetrës, përkundrazi te njëjtat ne tersi përputheshin mes vete dhe plotësonin njëra tjetrën dhe ne baze te te cilave gjykata vërtetoje gjendjen faktike si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, vlerësoi edhe dëshminë e dëshmitarit D.V, mirëpo nga dëshmia e tij nuk gjeti ndonjë relevance lidhur me gjendjen faktike te përshkruar si ne dispozitiv te aktgjykimit.

Pretendimet e te akuzuarit dhe mbrojtësit te tij, dhe vlerësimi i Gjykatës lidhur me këto pretendime:

Pretendimi i të akuzuarve përkatësisht mohimi i tij në shqyrtim gjyqësor se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale, për gjykatën një pretendim i tillë nuk është i qëndrueshëm pasi që gjatë shqyrtimeve gjyqësore nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor si nga deklarimi i dëshmitareve S.M, M.M, S.J dhe D.S, pastaj nga ekspertiza e ekspertit financiar dhe deklarimi i këtij eksperti ne shqyrtim gjyqësor dhe nga provat tjera materiale te administruara ne shqyrtim gjyqësor, u vertetua se i akuzuari e ka kryer veprën penale sipas aktakuzes te rikualifikuar nga gjykata Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-së. Përveç kësaj nga shkresat e lendes dhe nga deklarim i dëshmitarëve u vërtetua se i akuzuari drejtorit te kompanisë me dt.17.02.2016, i ka kthyer shumen prej 20,000 euro, dhe kjo tregon se pretendimet e te akuzuarit se ai nuk është kryerës i veprës penale janë te pa bazuara dhe te pa qëndrueshme.

Rikualifikimi i veprës penale;

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, e ka akuzuar të akuzuarin S.D, për veprën penale: Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes, provave që janë deponuar nga palët dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor të gjitha këto nga gjykata janë vlerësuar në raport me nenin 360 par.2 të KPP-së, sipas të cilit gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale.

Gjykata, duke u mbështetur në faktet dhe provat të proceduara në shqyrtimin gjyqësor, ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarve nuk përmbushën elementet e veprës penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet sipas aktakuzës pasi që sipas dispozitës ligjore nga neni 425 të KPK-se, veprën penale Përvetësimi në detyrë, e kryen personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës apo pozitës së tij”, pra edhe siç shihet nga kjo dispozitë ligjore këtë veprë penale mund ta kryej vetëm personi zyrtar.

Sipas dispozitës ligjore nga neni 120 pika 2.1 të KPRK-se, *person zyrtar nënkupton*: personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror; 2.2. personi i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme; ose 2.3. personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.

Në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës nuk kemi të bëjmë me person të zgjedhur ose të emëruar në organ shtetëror dhe as me person të autorizuar në organ shtetëror, po ashtu nuk kemi të bëjmë as me person i autorizuar në një organ shtetëror apo organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme e as me person i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj, pasi që siç u cek edhe më lartë në rastin konkret pala e dëmtuar ishte biznes individual e regjistruar në ARBK me pronar personin fizik S.M, kurse kompania “Auto Moto Remont”, fare nuk ka qene e regjistruar në evidencat e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës, ndërsa i akuzuari ishte vetëm kontabilist i këtyre ndërmarrjeve të angazhuar sipas kontratës, pra sipas vlerësimit të gjykatës, gjithnjë të bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, në rastin konkret i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qene person zyrtar.

Andaj nga këto fakte gjykata ka bere rikualifikimin e veprës penale duke vlerësuar se ne veprimet e te akuzuarit përmbushen elementet e veprës penale *Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-së*, pasi qe nga provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor u vërtetua se i akuzuari gjatë përfaqësimit te interesave pasurore të personit tjetër ne rastin konkret si kontabilist i kompanive te lart cekura i ka keqpërdorur autorizimet e tij me qellim qe vetes t'i sjell dobi pasurore te kundërligjshme duke i shkaktuar dem personit interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij, gjë qe ka pasur detyrim ligjore ndaj pronarit te pasurisë, detyrim qe rrjedh nga kontrata e punës e lidhur ne mes te akuzuarit dhe përfaqësuesit te palës se dëmtuar andaj gjykata te akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar sipas ligjit për këtë vepër penale, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e neni 360 par.1 të KPP-ës, e cila dispozitë nuk e detyron gjykatën me propozimin e prokurorisë lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale, në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike në masën e lejueshme, për faktin se gjendja faktike në një rast drejtpërdrejt e determinon kualifikimin juridike të veprës penale. Gjykata në përshkrimin faktik të aktgjykimit nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës në raport me kohën, vendin, të pandehurin, përveç se ka ndryshuar gjendjen faktike në aspektin faktik ka ndryshuar edhe kualifikimin ligjor të veprës penale.

Andaj, nga të gjitha provat e administruara në shqyrtimit gjyqësore në këtë çështje penale u vërtetua përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet te rikualifikuar nga gjykata, *Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-së*, për faktin nga administrimi i provave ne shqyrtim gjyqësor u vërtetua se ne periudhën kohore prej dt. 01.01.2005 e gjer me dt. 31.12.2015, në cilësinë e shefit te kontabilitetit në kompanitë “Auto Moto Drushtovo” në Mitrovicë dhe “Auto Moto Remont” në Mitrovicë, ka keqpërdorur autorizimet e tij duke i sjell vetes dobi pasurore te kundërligjshme dhe duke i shkaktuar dem personit interesat pasurore te te cilit ai i përfaqësonte-kompanitë e lartcekura, në atë mënyre që si kontabilist duke mos regjistruar në evidencat e kontabilitetit kthimin e akontacioneve (paradhënieve të punëtoreve), duke tërhequr para kesh nga banka dhe te njëjtat nuk janë regjistruar fare në evidencën e kontabilitetit, duke mos dorëzuar pazarin ditor në llogarinë bankare të kompanisë, e duke mos i regjistruar në evidencat e kontabilitetit paratë e kthyera nga personat që kishin huazuar para nga kompania, dhe ne këtë mënyrë kompanisë “Auto Moto Drushtvo”, me veprimet e te akuzuarit i është shkaktuar demi ne lartësinë prej 15,689,595 dinar, kurse kompanisë “ Auto Moto Remont” i është shkaktuar demi prej 21,222,954 dinar, qe gjithsej

demi për te dy kompanitë arrin vlerën prej 36,912,549 dinar, e konvertuar ne euro 273,107.39 euro.

Andaj nga administrimi i provave ne shqyrtim gjyqësor u vërtetua se i akuzuari S.D me veprimet e tij gjatë përfaqësimit te interesave pasurore të personit tjetër ne rastin konkret si kontabilist i kompanive te lart cekura duke i keqpërdorur autorizimet e tij ka përfutuar dobi pasurore te kundërligjshme për vete nga kompania “Auto Moto Drushtvo”, për vitet 2005-2011, shumen ne lartësi prej 15,689,595 dinar, kurse nga kompania “ Auto Moto Remont” për vitet 2008-2015, shumen prej 21,222,954 dinar, qe gjithsej nga te dy kompanitë arrin vlerën prej 36,912,549 dinar, e konvertuar ne euro 273,107.39 euro, për çka gjykata te njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoje dënimin si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Matja e dënimit:

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 73 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit, si rrethane lehtësuese gjykata gjeti faktin se i akuzuari për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin pasi qe ne shkresat e lendes nuk kemi te dhëna se ai eshte dënuar me pare per kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, pastaj faktin se i njëjti është i moshës së vjetër-pensionist tani me ka mbushur 78 vite, ndërsa si rrethane renduese për te akuzuarin gjykata gjeti mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale dhe shkallen e përgjegjësisë penale te te akuzuarit.

Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Kërkesa pasurore juridike:

Gjykata të akuzuarin S.D në bazë të nenit të 463 par. 2 të KPP-së, e obligoi që në emër të kompensimit të demit te shkaktuar palës se dëmtuar kompanisë “Auto Moto Drushtvo”, t’ia kompensoi shumën prej 15,689,595 dinar, kurse kompanisë “ Auto Moto Remont” shumen prej 21,222,954 dinar, apo gjithsej për te dy kompanitë shumen prej 36,912,549 dinar, e konvertuar ne euro 273,107.39 euro. Të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes se formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Shpenzimet e procedurës penale:

Në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, Gjykata të akuzuarin S.D, e obligon që në emër të shpenzimeve të procedurës penale e në emër të paushallit gjyqësor ta paguaj shumen prej njëqind (100) Euro dhe shumën prej pesëdhjetë (50) Euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave.

Në bazë te të dhënave të shënuara me larte u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.51/2019, me datën 21.12.2022

Procesmbajtësja:

Shqipe Sejdiu

Kryetari i trupit gjykues

Mentor Hajraj

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.